

Rregullore për mënyrën dhe procedurën e përpunimit të kërkesave për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve si dhe qëllimi i verifikimit të kërkesave
2.11.2009 12:43:46

Në përputhje me nenin 20 paragrafi 2 pika a e ligjit “Për kontrollin e lëvizjes së armëve dhe pajisjeve ushtarake” (“Fletorja Zyrtare e Bosnjë-Hercegovinës” numër: 53/09) dhe me miratimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Sërbska të Bosnjë-Hercegovinës, Ministrive të Punëve të Brendshme të kantoneve dhe Policisë së Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, Zëvendësministri i Sigurisë miraton:

**RREGULLOREN PËR MËNYRËN DHE PROCEDURËN E PËRPUNIMIT TË KËRKESAVE PËR
DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LËVIZJEN E ARMËVE SI DHE QËLLIMI I VERIFIKIMIT TË
KËRKESAVE**

I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1.

(Objekti i Rregullores)

- (1) Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra dhe procedura e përpunimit të kërkesave për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve dhe pajisjeve ushtarake (në vijim referuar si: armët), përmbajtja e kërkesave dhe qëllimi i verifikimit të kërkesave.
- (2) Kërkesat për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve përpunohen sipas mënyrës dhe kushteve të përcaktuara në ligjin “Për kontrollin e lëvizjes së armëve dhe pajisjeve ushtarake (në vijim referuar si: ligji), në këtë Rregullore dhe sipas rregullave të përgjithshme të procedurës administrative.

II - DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LËVIZJEN E ARMËVE NË RASTIN E KALIMIT TË KUFIRIT SHTETËROR TË BOSNJË-HERCEGOVINËS (IMPORT, EKSPORT, TRANSIT)

Neni 2.

(Depozitimi i kërkesës)

Kërkesa për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve depozitohet në Ministrinë e Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës (në vijim referuar si: Ministria e Sigurisë e Bosnjë-Hercegovinës) në rastin e lëvizjes së armëve përmes kufirit shtetëror të Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 3.

(Përmbajtja e kërkesës)

- (1) Kërkesa e përmendur në nenin 2 të kësaj Rregulloreje depozitohet duke përdorur formularin e përcaktuar me ligj.
- (2) Bashkë me kërkesën për dhënien e miratimit depozituesi i kërkesës është i detyruar të paraqesë:
 - a) lejen e lëshuar nga Ministria e Tregtisë së Jashtme dhe Marrëdhënieve Ekonomike në rastin e importit, eksportit ose transitit;
 - b) miratimin për blerjen e armëve;
 - c) vërtetimin e përdoruesit fundor të armëve;
 - d) vërtetimin e pagesës së taksës administrative.
- (3) Vërtetimi i përmendur në paragrafin 2 pika c e këtij neni është kontrata për dërgimin ose urdhri i blerjes në rastin e lëvizjes së armëve për nevojat e autoriteteve të përmendura në nenin 2 të ligjit, ose deklarata e poseduesit të armëve në rastin e lëvizjes së armëve nga njëri vend në tjetrin.
- (4) Në rast importi të armëve për nevojat e veta, krahas vërtetimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, mund të përdoret si vërtetim i përdoruesit fundor deklarata e poseduesit se armët do të përdoren për qëllime vetjake.

Neni 4.

(Dorëzimi i dokumentacionit)

- (1) Bashkë me kërkesën për dhënien e miratimit depozituesi i kërkesës është i detyruar të depozitojë origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentacionit të përmendur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje.
- (2) Nëse ekzistojnë arsye të justifikuara, dokumentacioni i nevojshëm mund të dërgohet edhe nëpërmjet faksit, me kusht që depozituesi i kërkesës të depozitojë, menjëherë dhe jo më vonë se shtatë ditë nga dita e dhënies së miratimit, dokumentacionin origjinal ose kopjen e noterizuar të dokumentacionit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 5.

(Dhënia e miratimit)

Nëse gjatë procedurës për dhënien e miratimit konstatohet se janë përmbushur kushtet për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve përmes kufirit shtetëror të Bosnjë-Hercegovinës (import, eksport dhe transit), Ministria e Sigurisë e Bosnjë-Hercegovinës merr një vendim të veçantë.

Neni 6.

(Njoftimi për miratimin e dhënë)

- (1) Pasi merr vendimin e përmendur në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, Ministria e Sigurisë e Bosnje-Hercegovinës ia dorëzon këtë vendim depozituesit të kërkesës.
- (2) Pas marrjes së vendimit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni, depozituesi i kërkesës informon Ministrinë e Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës për datën e saktë, kohën dhe itinerarin e lëvizjes ndërsa Ministria e Sigurisë informon Ministrinë e Punëve të Brendshme të entiteteve dhe Policinë e Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës duke dhënë numrin e miratimit të dhënë për transport.
- (3) Ministrinë kompetente të Punëve të Brendshme të entiteteve dhe Policia e Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës janë të detyruara që pas marrjes së njoftimit nga paragrafi 2 i këtij neni të kryejnë njoftimet e nevojshme mbi lëvizjen e armëve përgjatë itinerarit në territorin brenda juridiksionit të tyre.

Neni 7.

(Refuzimi i kërkesës)

Nëse gjatë procesit del se nuk janë përmbushur kushtet e nenit 3 të kësaj Rregulloreje për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve përgjatë kufirit shtetëror (import, eksport dhe transit), atëherë merret vendimi për refuzimin e kërkesës.

III - DEPOZITIMI I KËRKESËS PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LËVIZJEN E ARMËVE MIDIS ENTITETEVE, MIDIS ENTITETEVE DHE DISTRIKTIT TË BËRÇKOS TË BOSNJË-HERCEGOVINËS, BRENDIA ENTITETEVE OSE BRENDIA DISTRIKTIT TË BËRÇKOS TË BOSNJË-HERCEGOVINËS.

Neni 8.

(Depozitimi i kërkesës)

Kërkesa për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve midis entiteteve ose midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, brenda entiteteve ose brenda Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës depozitohet në njësinë kompetente organizative nga territori i së cilës dërgohen armët si vijon:

- Qendrat e sigurisë publike të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Sërbska të Bosnjë-Hercegovinës (në vijim referuar si: Qendra);
- Departamentet policore në Ministrinë e Punëve të Brendshme të kantoneve;
- Policia e Distriktit të Bërçkos e Bosnjë-Hercegovinës.

Neni 9.

(Përmbajtja e kërkesës)

- (1) Kërkesa e përmendur në nenin 8 të kësaj Rregulloreje depozitohet duke përdorur formularin e përcaktuar në ligj.
- (2) Bashkë me kërkesën për dhënien e miratimit depozituesi i kërkesës është i detyruar të paraqesë:
 - a) miratimin për blerjen e armëve;
 - b) vërtetimin e përdoruesit fundor të armëve;
 - c) vërtetimin e pagesës së taksës administrative.
- (3) Vërtetimi i përmendur në paragrafin 2 pika b e këtij neni është kontrata për dërgimin ose urdhri i blerjes në rastin e lëvizjes së armëve për nevojat e autoriteteve të përmendura në nenin 2 të ligjit, ose deklarata e poseduesit të armëve në rastin e lëvizjes së armëve nga njëri vend në tjetrin.
- (4) Në rast importi të armëve për nevojat e veta, krahas vërtetimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, mund të përdoret si vërtetim i përdoruesit fundor deklarata e poseduesit se armët do të përdoren për qëllime vetjake.

Neni 10.

(Dorëzimi i dokumentacionit)

- (1) Bashkë me kërkesën për dhënien e miratimit depozituesi i kërkesës është i detyruar të depozitojë origjinalin ose kopjen e noterizuar të dokumentacionit të përmendur në nenin 9 të kësaj Rregulloreje.
- (2) Nëse ekzistojnë arsye të justifikuara, dokumentacioni i nevojshëm mund të dërgohet edhe nëpërmjet faksit, me kusht që depozituesi i kërkesës të depozitojë, menjëherë dhe jo më vonë se shtatë ditë nga dita e dhënies së miratimit, dokumentacionin origjinal ose kopjen e noterizuar të dokumentacionit në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 11.

(Miratimi)

- (1) Përpara dhënies së miratimit për lëvizjen e armëve, njësia kompetente organizative e përmendur në nenin 8 të kësaj Rregulloreje i dorëzon Ministrisë së Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës kopjen e nevojshme të dokumentacionit me qëllim dhënien e miratimit si më poshtë:
 - kërkesën për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve të përcaktuar nga ligji;
 - miratimin për blerjen e armëve;
 - vërtetimin e përdoruesit fundor të armëve;
 - formularin e kërkesës për dhënien e miratimit të përcaktuar në formularin numër 1 të kësaj Rregulloreje;
 - projektvendimin për miratimin për lëvizjen e armëve.
- (2) Kërkesa për dhënien e miratimit si dhe formulari i miratimit të dhënë janë dhënë në formularët nr. 1 dhe nr. 2 të kësaj Rregulloreje.

Neni 12.

(Dhënia e miratimit)

Nëse gjatë procedurës për dhënien e miratimit konstatohet se janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 9 të kësaj Rregulloreje për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve midis entiteteve ose midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, ose brenda entiteteve apo brenda Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, atëherë merret një vendim i veçantë nga ana e njësisë kompetente organizative të përmendur në nenin 8 të kësaj Rregulloreje.

Neni 13

(Njoftimi për miratimin e dhënë)

- (1) Depozituesi i kërkesës informon për datën e saktë të lëvizjes së armëve autoritetin që ka marrë vendimin.
- (2) Me kërkesë të Ministrisë së Sigurisë së Bosnjë-Hercegovinës, Ministrinë kompetente të Punëve të Brendshme të entiteteve dhe Policia e Distriktit të Bërçkos e Bosnjë-Hercegovinës e informon Ministrinë për datën e saktë të lëvizjes së armëve dhe për çështje të tjera që lidhen me lëvizjen e armëve.

(3) Njësitë kompetente organizative të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës Serbska të Bosnjë-Hercegovinës, të Ministrive të Punëve të Brendshme të kantoneve dhe Policia e Distriktit të Bërçkos janë të detyruara që pas marrjes së njoftimit për datën e lëvizjes së armëve në territorin brenda juridiksionit të tyre, të kryejnë njoftimet e nevojshme mbi lëvizjen e armëve përgjatë itinerarit.

Neni 14.

(Refuzimi i kërkesës)

Nëse gjatë procedurës rezulton se nuk janë përmbushur kushtet e nenit 9 të kësaj Rregulloreje për dhënien e miratimit për lëvizjen e armëve midis entiteteve ose midis entiteteve dhe Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, ose brenda entiteteve apo brenda Distriktit të Bërçkos të Bosnjë-Hercegovinës, në këtë rast njësia kompetente organizative e përmendur në nenin 9 të kësaj Rregulloreje merr vendim për refuzimin e kërkesës.

IV - DISPOZITA KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 15.

(Formularët)

Formularët numër 1 dhe 2 gjenden bashkëlidhur kësaj Rregulloreje dhe janë pjesë përbërëse e saj.

Neni 16.

(Hyrja në fuqi)

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj dhe do të publikohet në “Fletoren Zyrtare të Bosnjë-Hercegovinës”).

Numër: _____/09

Sarajevë: _____ 2009

Zëvendësministri
Mijo Krešić